




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV SYRI VISION
Zeqir Haxhija
Drejtor
Gjakovë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/39 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TV SYRI VISION (Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 11 tetor 2016 ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, me të cilin janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OSHMA) në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. Me datën 26 janar 2021 KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse ka iniciuar monitorim të programit gjatë fushatës zgjedhore. Bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar pikë reklamuese politike të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), konkretisht të kandidatës Shqipe Selimi në të cilën shihet prezencë e fëmijëve, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 13 shkurt 2021 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar që të veprojë në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Analiza ligjore

5. Përmes kësaj, Komisioni i Pavarur i Mediave konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

6. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar pikë reklamuese politike të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), konkretisht të kandidatës Shqipe Selimi në të cilën shihet prezencë e fëmijëve, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”


7. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Vendim

8. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2 të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



16.03.2021
Datë